

# Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri

Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

## Metadatal Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore .....	2
4. Njësia matëse .....	3
5. Periudha e referencës .....	3
6. Mandati institucional.....	3
7. Konfidencialiteti .....	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	5
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	5
11. Manaxhimi i cilësisë .....	6
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	7
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	8
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor .....	10
19. Komente.....	12
Aneks .....	12

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave Afatshkurtra dhe Turizmit pranë Ndërmarrjeve, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Klea Allushi
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Statistikave Afatshkurtra dhe Turizmit pranë Ndërmarrjeve
1.5. Adresa postare	Rruga Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 101
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:kallushi@instat.gov.al">kallushi@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	19.03.2026
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	19.03.2026
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	19.03.2026
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri (IPI) shërben për matjen e ndryshimeve tremujore në volumnin e prodhimit industrial. Burimi kryesor është Vrojtimi Tremujor i Statistikave Afatshkurtra, Pyetësi për Industrinë (Moduli 121) i kombinuar me të dhëna administrative.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Klasifikimi statistikor i aktiviteteve ekonomike bazohet në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev. 2).
3.3. Mbulimi i sektorit	Vrojtimi tremujor përfshin ndërmarrjet e klasifikuara në Seksionet B, C, D dhe E të NACE Rev. 2. Vrojtimi përfshin të gjitha ndërmarrjet e mëdha e të mesme, si dhe një numër përfaqësues të ndërmarrjeve të vogla. Një shtresë përcaktohet sipas klasave dhe bazohet në numrin e të punësuarve.
3.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet	Qëllimi i Indeksit të Volumit të Prodhimit Industrial është të matë ndryshimet në volumnin e prodhimit në intervale të shkurtra dhe të rregullta, kryesisht tremujor dhe vjetor. Ai mundëson matjen e trendit të volumnit në vlerën e shtuar

	<p>gjatë një periudhe të caktuar referimi. Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri është një matës teorik që duhet të përafrohet me matjen praktike. Vlera e shtuar me çmime bazë mund të llogaritet nga shitjet neto (pa TVSH dhe taksa të tjera të ngjashme të zbritshme të lidhura drejtpërdrejt me shitjet neto):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• + prodhim i kapitalizuar;</li> <li>• + të ardhura të tjera operative;</li> <li>• +/- ndryshimet në inventarë;</li> <li>• -blerjet e mallrave dhe shërbimeve;</li> <li>• -taksat për produktet të cilat janë të lidhura me shitjet neto, por nuk zbriten;</li> <li>• + çdo subvencion për produktet e marra.</li> </ul>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore është ndërmarrja.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore përfshin njësitet statistikore (ndërmarrje), të cilat operojnë në aktivitete ekonomike sipas NVE Rev. 2, në sektorin e industrisë (seksionet B, C, D dhe E, përkatësisht ndarjet 05-39), sipas Regjistrimit Statistikor të Biznesit. Ndërmarrjet me 1-9 të punësuar janë vrojtuar me kampion, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë vrojtuar tërësisht.
3.7. Zona e referencës	Indeksi i Volumit të Prodhimit Industrial mbulon të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në nivel kombëtar.
3.8. Mbulimi në kohë	Vrojtimi tremujor i Statistikave Afatshkurtra referuar Indeksit të Volumit të Prodhimit Industrial daton prej vitit 2005 e në vazhdim.
3.9. Periudha bazë	Duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2024, aplikohet viti bazë 2021 (2021 = 100)
<b>4. Njësia matëse</b>	
4.1 Njësia matëse	Njësitet e matjes janë indekset dhe ndryshimet në përqindje (%).
<b>5. Periudha e referencës</b>	
5.1 Periudha e referencës	Informacioni i grumbulluar dhe përpunuar i referohet periudhave tremujore. Ky raport i përket vitit të referencës 2025.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore ku mbështeten indikatorët e ATN-së konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligji Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”;</a></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare, 2022-2026.</a></li> </ul> <p>Klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Rregullorja (BE) 2019/2152 për Statistikat Evropiane të Biznesit;</a></li> <li>• <a href="#">Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2020/1197</a> e cila përcakton variablat dhe shpeshhtësinë e përpilimit të të dhënave, shfuqizimi i porositë të reja të marra për ndërtimin e ndërtesave dhe porositë e reja të marra për inxhinierinë civile.</li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	<p>Transmetimi i të dhënave të ATN-së ka filluar në tremujorin e tretë të vitit 2017 në nivelin Evropian. Nga tremujori i parë i vitit 2018 të dhënat për treguesit kryesorë transmetohen rregullisht në Eurostat. Transmetimi i të dhënave të Indeksit të Volumit të Prodhimit në Industri në Eurostat nuk ka filluar ende, sepse Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri prodhohet mbi baza tremujore. Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri transmetohet rregullisht në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) përmes (e-GDDS).</p>
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe kërkimore bazuar në Ligjin Kombëtar të Statistikave Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, datë 10.03.2018 dhe <a href="#">Ligj Nr. 124/2024 për mbrojtjen e të Dhënave Personale</a>. Në nenin 31 të ligjit të statistikave thuhet si vijon: “Të dhënat e mbledhura për prodhimin e statistikave zyrtare do të trajtohen nga INSTAT si konfidenciale dhe do të përdoren vetëm në tabela të grumbulluara që nuk do të identifikojnë njësinë e informacionit burimor. Identifikimi i drejtpërdrejtë nënkupton kur një njësi statistikore është identifikuar drejtpërdrejt nga emri ose adresa e saj ose nga çdo numër i caktuar zyrtarisht dhe zakonisht i njohur.” Kur përpunimi i të dhënave bëhet në atë mënyrë që lejon identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshme.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësisë statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësisë statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga Instituti i Statistikave vetëm në rast se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor;</li> <li>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</li> </ol>

	<p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të përcaktojnë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
<b>8. Politika e botimit</b>	
8.1. Kalendarin e publikimeve	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë publikuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftimet dhe vonesat bëhen të ditura paraprakisht në këtë kalendarin. Në rast vonesash specifikohet data e publikimit të ardhshëm, si dhe jepet shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	<p><a href="#">Kalendari i publikimeve</a> është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.</p>
8.3. Aksesin i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikant zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë akses të menjëhershëm dhe të barabartë. Përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, në kuadër të përgjegjësisë të tyre për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Website</a> – online release;</li> <li>• Kërkesat e shkruara (me postë ose email);</li> <li>• <a href="#">Publikimi</a>;</li> <li>• <a href="#">Kërkesa për të dhëna</a>, seksioni për përdoruesit e jashtëm.</li> </ul>
<b>9. Shpeshtësia e shpërndarjes</b>	
9.1 Shpeshtësia e shpërndarjes	<p>Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri shpërndahet me bazë tremujore.</p>
<b>10. Aksesin në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	<p>Sipas kalendarit të publikimeve, çdo tremujor publikohet njoftim për media mbi Statistikat Afatshkurtra. Formatin e njoftimit për shtyp përcaktohet nga Sektori i Publikimeve, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i</p>

	Statistikave Afatshkurtra publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Përdoruesit mund t'i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT nën temën: <a href="#">Statistikat Afatshkurtra</a> .
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë shqip dhe anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit PC-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e Statistikave Afatshkurtra. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: <a href="#">Databaza Statistikore</a> .
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat në nivel mikro nuk bëhen të disponueshme, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohen për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 7 Ligji Nr. 17/2018, datë 17.04.2018 "Për Statistikat Zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar kontakti: <a href="#">Kërko të dhëna</a> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <a href="#">metodologjinë</a> mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave Afatshkurtra dhe Turizmit pranë Ndërmarrjeve dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ATN për qëllime të brendshme.
<b>11. Menaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në Ligjin Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me <a href="#">Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane</a> . INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.

11.2. Vlerësimi i cilësisë	Kontrollet e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryhen përgjatë gjithë procesit dhe më pas analizohen nga stafi me qëllim përmirësimin e cilësisë së statistikave. Stafi ka përvojën e duhur për plllogaritjen e indeksit dhe është i përfshirë në faza të ndryshme të përpilimit të tij, të tilla si: kontrollet fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollet përfundimtare. Është bërë një krahasim me të dhënat e vitit të kaluar për të parë nëse ka ndonjë koherencë të të dhënave apo nëse ka pasur ndryshime të mëdha.
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit janë klasifikuar në të jashtëm dhe të brendshëm.</p> <p>Përdoruesit e jashtëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ministritë dhe administrata publike që përdorin të dhënat për qëllime të planifikimit të politikave ekonomike dhe sociale;</li> <li>• Universitetet (profesorë, studentë të diplomuar dhe pasuniversitarë), organizata kërkimore;</li> <li>• OJQ kombëtare dhe ndërkombëtare;</li> <li>• Ndërmarrjet;Publiku i gjerë që merr informacionin përmes mediave nëpërmjet publikimeve të bëra nga Zyra e Statistikave.</li> </ul> <p>Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Llogarive Kombëtare;</li> <li>• Sektori i Regjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve.</li> </ul>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT kryen çdo vit vrojtimin për Matjen e Kënaqësisë së Përdoruesve, rezultatet e të cilit do të publikohen në web-in e INSTAT në linkun <a href="#">Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve</a> .
12.3. Plotshmëria	Për sa i përket plotshmërisë së Statistikave Afatshkurtra, ajo ndërtohet në përputhje me rregulloret e Eurostat. Shkalla e plotshmërisë së të dhënave të vrojtimit të Statistikave Afatshkurtra për vitin 2025 është 62,0 %. Kjo llogaritje bazohet në rregulloret evropiane. Si rezultat llogaritja e Indeksit të Volumit të Prodhimit Industrial dhe të dhënat e siguruara janë në përputhje me rregulloret përkatëse të BE-së.
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Popullata e vëzhguar e Statistikave Afatshkurtra 2025 përfshin afërsisht 11,462 ndërmarrje për çdo tremujor, nga të cilat afërsisht 2,500 në aktivitetin Industrial. Dizajni i kampionimit është kampionim i thjeshtë i rastësishëm, i shtresëzuar.

	<p>Kriteri i përdorur për shtresëzim është numri i personave të punësuar sipas NVE Rev. 2 në nivel 3 shifror. Llogaritja e vlerësimeve të të dhënave statistikore dhe analiza e njësive outlier kryhet rregullisht. Duke marrë parasysh shkallën e lartë të përgjigjes, shkalla e saktësisë së përgjithshme është e lartë. Për të llogaritur vlerësimet, përdoret vlerësuesi Horvitz-Thompson, që është i paanshëm. Saktësia e vlerësimeve arrihet duke eliminuar gabimet e kampionimit dhe të jo kampionimit, të tilla si mbulimi, pa përgjigje, gabimet e përgjigjes dhe gabimet e përpunimit. Arsyet e shfaqjes së gabimeve në mbulim janë keq-klasifikimi i njësive dhe ndryshimet në statusin e njësive raportuese. Është e detyrueshme t'i përgjigjesh vrojtimit. Në rast mos-përgjigje, njësitë kontaktohen përmes telefonit dhe postës elektronike. Gabimi në kampionim në përqindje (CV) llogaritet për treguesit kryesorë të vrojtimit që publikohen çdo tremujor.</p>						
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Gabimet e kampionimit trajtohen në raportet e brendshme teknike, ku për çdo indikator në vrojtimit llogaritet varianca e totalit, si dhe gabimi standard relativ, për eliminimin e efektit negativ që jep lëvizja e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes në serinë kohore të vlerave. Të gjitha vlerat e treguesve përgjithësohen për të përfaqësuar gjithë popullatën në studim.</p>						
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën. Shkalla e mos-përgjigjes në nivel rekordi mesatarisht për ATN 2025 është 2,44%.</p>						
<b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b>							
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e Indeksit të Volumit të Prodhimit në Industri janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 78 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 78 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Indeksit të Volumit të Prodhimit në Industri është 31 dhjetori 2025.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2025</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/19/2026</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>78</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2025	Data e publikimit	3/19/2026	Afatet kohore	78
Periudha referuese	12/31/2025						
Data e publikimit	3/19/2026						
Afatet kohore	78						
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat e Indeksit të Volumit të Prodhimit në Industri publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Prodhimit në Industri ka qënë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2025</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>3/19/2026</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2025	Data e shpallur	3/19/2026		
Periudha referuese	12/31/2025						
Data e shpallur	3/19/2026						

	Data e publikimit	3/19/2026
	Vonesa në kohë	0
<b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b>		
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat për Indeksin e Volumit të Prodhimit në Industri janë përgatitur në përputhje me metodologjinë e Eurostat dhe janë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. Të dhënat janë gjithëpërfshirëse dhe prodhohen në nivel vendi.	
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Ndër vite Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri ka pësuar ndryshime në fushën e mbulimit dhe në metodën e zgjedhjes. Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve ka filluar për herë të parë në vitin 2005. Ndërmarrjet më 1-9 të punësuar janë me kampionim, ndërsa ndërmarrjet me mbi 10 të punësuar janë marrë me listim (në mënyrë të plotë) pa ndryshuar fushën e mbulimit. Në vitin 2012 ndryshon popullsia si rezultat i përditësimit të Regjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve me rezultatet e Regjistrimit të Ndërmarrjeve Ekonomike, 2010. Të gjitha ndryshimet janë raportuar në shpjegimet metodologjike që shoqërojnë publikimet përkatëse. Në vitin 2014 në Indeksin e Volumit të Prodhimit në Industri u implementua nomenklatura e aktiviteteve ekonomike, NVE Rev. 2, struktura e azhornuar e peshave dhe ndryshimi i periudhës bazë të indekseve nga 2005 në 2010. Në vitin 2019 periudha bazë e indekseve ndryshoi nga 2010 në 2015. Në vitin 2024 në SASH përditësohet struktura e peshave dhe ndryshon periudha bazë e indekseve nga 2015 në 2021. Të gjitha këto ndryshime në serinë e indekseve nuk janë shkëputur, por indekset janë hedhur përsëri. Këto ndryshime janë raportuar në shpjegimet metodologjike që bashkohen me botimet përkatëse. Të dhënat e Statistikave Afatshkurtra sipas tremujorëve bazuar në Klasifikimin e Aktivitetit Ekonomik NVE Rev. 2, datojnë që nga viti 2006 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 20 vitesh (<math>CC2=JlastJfirst+1=20</math>). Të dhënave u bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>	
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri është vlerësuar duke përdorur të dhënat e TVSH. Për ndërmarrjet që të dhënat e TVSH nuk janë të disponueshme është përdorur vrojtimit me zgjedhje. Nuk ekziston informacion tjetër statistikor, i cili mund të përdoren për kontrollin e koherencës.	
15.4. Koherenca e brendshme	Koherenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar përpara se ato të finalizohen. Lidhja midis variablave është kontrolluar dhe koherenca midis serive të ndryshme të të dhënave është konfirmuar. Specialistët e Statistikave Afatshkurtra punojnë së bashku me specialistë të drejtorive përkatëse për të siguruar qëndrueshmërinë dhe koherencë të treguesve statistikorë.	

## 16. Kostoja dhe ngarkesa

### 16.1 Kostoja dhe ngarkesa

Kostoja e Statistikave Afatshkurtra përfshin informacion mbi numrin e stafit të përhershëm dhe të përkohshëm. Numri i stafit të ATN është:

- Totali i stafit në Zyrën Qendrore: 1 punonjës;
- Specialistët e logjistikës: 1 punonjës;
- Anketues: 124 të punësuar;
- Kontrollorë: 2 të punësuar.

Transmetimi i të dhënave administrative mundësohet pa kosto përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara midis INSTAT dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT). Burimet Statistike (Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ATN e mëparshme) janë gjithashtu pa kosto, pasi janë konsideruar si përdorues të brendshëm. Stafi i ATN menaxhon kontrollin dhe analizën e të dhënave, kështu që edhe këto dy procese nuk kanë kosto të tjera shtesë.

## 17. Rishikimi i të dhënave

### 17.1. Politika e rishikimit

Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantuara nga INSTAT si më poshtë:

- [Politika e revizionimit](#);
- [Politika e trajtimit të gabimeve](#).

E njëjta politikë revizionimi aplikohet ndaj publikimeve dhe transmetimeve kombëtare në Eurostat.

### 17.2. Praktika e rishikimit

Të dhënat e publikuara nuk konsiderohen përfundimtare ato mund të rishikohen. Të dhënat mund të rishikohen për një sërë arsyesh si: implementimi i klasifikimit të ri NVE, ndryshime metodologjike, burime të reja informacioni ose të përmirësimeve të të dhënave dhe korrigjime të gabimeve. Rishikimi i tremujorit paraardhës është i mundur të kryhet gjatë çdo tremujori dhe në fund të çdo viti mund të kryhen korrigjime për të katër tremujorët. Nuk janë kryer rishikime mbi të dhënat e “Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri” për vitin 2025. Nuk ka vlerësime numerike të indikatorëve MR dhe MAR.

## 18. Përpunimi statistikor

### 18.1. Burimi i të dhënave

Të dhënat bazohen në anketat statistikore tremujore dhe të dhënat administrative. Baza e përzgjedhjes është Regjistri i ndërmarrjeve aktive për vitin referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve bëhet sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike, NACE Rev. 2. Popullata në studim përcaktohet nga dy

	<p>kritere themelore: Madhësia e ndërmarrjes (bazuar në numrin e të punësuarve) dhe aktiviteti ekonomik brenda fushës së studimit, me prerje. Metoda e përdorur e përzgjedhjes është Përzgjedhje e thjeshtë e Rastit me Shtresëzim (SRS). Shtresëzimi bazohet në kombinimin e aktivitetit ekonomik me grupin e madhësisë së ndërmarrjes. Treguesit janë paraqitur për aktivitete ekonomike sipas fushave të përcaktuara në rregulloren e Statistikave Afatshkurtra dhe gjithashtu bazuar në nevojat e përdoruesve.</p>
18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen çdo tremujor.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Gjatë vitit 2025 të dhënat janë siguruar në mënyrë të kombinuar nëpërmjet burimeve administrative dhe intervistimit të drejtpërdrejtë nga anketuesit pranë ndërmarrjeve. Kohëzgjatja e intervistimit të drejtpërdrejtë ishte 15 ditë pas tremujorit referues dhe u krye vetëm për ndërmarrjet të cilat nuk ishin subjekt i deklarimit në burimet administrative. Gjatë vitit referencë nuk është planifikuar ndryshim në pyetësor.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënat e marra nga vrojtimi dhe nga skedari i TVSH-së vlerësohen duke përdorur rregulla logjike të vlefshme. Në nivel kombëtar, editimi përfshin studimin e të dhënave të të anketuarve me qëllim identifikimin (dhe korigjimin) e gabimeve. Jo të gjitha gabimet mund të identifikohen, por qëllimi është të zbulohen ato gabime që kanë ndikim të madh tek rezultatet. Rregullat për identifikimin e gabimeve mund të vënë në dukje gabime të mundshme të cilat kërkojnë një studim të mëtejshëm për të kuptuar se ku qëndron gabimi përkundrejt një rezultati të pazakontë ose mund të evidentojnë gabime të përcaktuara. Redaktimi (editimi) përfshin kontrollë për tërësinë, që vlerat janë brenda kufijve të caktuar dhe se vlerat për variablat e lidhur janë koherent. Redaktimi i të dhënave mund të bëhet gjatë ose pas hedhjes së të dhënave. Përgjigjet mund të krahasohen me përgjigjen e tremujorëve të mëparshëm. Mospërputhja ose devijimet e mëdha (jashtë një diapazoni të paracaktuar) tregojnë se një studim më i thellë do ishte i rëndësishëm. Kjo mund të rezultojë në redaktim të dhënash. Në kontekstin e afatit kohor, procesi i redaktimit mund të jetë i dizajnuar për t'i dhënë përparësi kryesore atyre njësi outlier që kanë më shumë nevojë për redaktim për hir të aggregateve të besueshëm. Duke adresuar rastet më ekstreme, arrihen përmirësime domethënëse në cilësinë dhe besueshmërinë e të dhënave aggregate.
18.5. Përpilimi i të dhënave	<p>Nivel Kombëtar</p> <p>Hapi i parë është mbledhja e informacionit nga burimet administrative dhe intervistat e drejtpërdrejta pranë ndërmarrjeve.</p> <p>Qëllimi kryesor është transformimi i këtij informacioni në një formë të përdorshme statistikore. Proces i ndjekur është si më poshtë:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli fizik i pyetësorëve (verifikimi i plotësisht të pyetësorëve sipas standardeve të skanimit);</li> <li>• Kontrolli logjik i pyetësorëve (kontrolli i shënimit logjik të indikatorëve të përgjigjes, përshkrimit të aktivitetit dhe kodifikimit si dhe kontrolli i plotësisht të shifrave);</li> <li>• Pas hedhjes së të dhënave, gabimet dhe mospërputhjet evidentohen dhe korrigjohen përgjatë redaktimit (editimit);</li> <li>• Mos-përgjigjet dhe mungesa e informacionit për ndërmarrjet e rëndësishme (ndërmarrjet e mëdha) duhet të plotësohen nëpërmjet procesit të imputimit duke përdorur informacionin e marrë nga burime të tjera;</li> <li>• Krahasueshmëria e të dhënave (ndërmjet të dhënave të vrojtimit dhe të dhënave administrative, periudhat e mëparshme ose trendet);</li> <li>• Analiza e rezultateve për çdo fushë publikimi (domein);</li> <li>• Rezultatet e plota dhe të pastra të të dhënave shërbejnë më pas për fazën e peshimit dhe ri-peshimit;</li> <li>• Të dhënat e agreguara krahasohen me të dhëna nga burime të tjera;</li> <li>• Dy fazat e fundit mund të jenë subjekt analizash të tjera, në funksion të rezultateve sipas fushave të publikimit (domein-et). Së fundi, kur analiza statistikore ka përfunduar, këto të dhëna përcaktohen si grup informacioni jo-publike. Para shpërndarjes së rezultateve, fazë shumë e rëndësishme është ruajtja e konfidencialitetit të këtij informacioni.</li> </ul>
18.6. Rregullimi	<p>Indeksi i Volumit të Prodhimit në Industri llogaritet i përshtatur sezonalisht dhe i papërshtatur sezonalisht. Përshtatja sezonale në seritë tremujore të Prodhimit zbatohet duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2.4. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore 2006 – 2025. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizshme, Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave tremujore. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.</p>
<b>19. Komentë</b>	
<b>Aneks</b>	